

V E N D I M
Nr.287 datë 14.6.1993

**PËR RRITJEN E TË ARDHURAVE PËR INSTITUCIONET BUXHETORE TË SISTEMIT
TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.478, datë 7.11.1992 "Për krijimin, evidencimin dhe administrimin e të ardhurave që realizojnë institucionet buxhetore nga shërbimet që ato u ofrojnë të tretëve", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Kryesia e Këshillit të Ministrave,

V E N D O S I:

Institucioneve buxhetore të sistemit të Ministrisë së Kulturës të Rinisë dhe Sporteve i lihen në dispozicion 70 për qind e të ardhurave, kurse 30 për qind të derdhen në llogarinë e Buxhetit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi